

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Vitisë z. Nexhmedin Arifi**

I nderuari z. Arifi,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Administratë efikase;
- Shërbime të mira shëndetësore;
- Mbrojtje të mjedisit;
- Zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Investime në infrastrukturë rrugore, arsim, shëndetësi, rini dhe sport;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Zhvillim ekonomik – si parakusht për tërheqjen e investitorëve dhe punësimin e të rinjve;
- Mbi 12 milionë euro investime për vitin 2010;
- Përfundimin e punëve në kompleksin e varrezave të dëshmorëve;
- Ndërtimin e një zone industriale në fshatin Dobresh;
- Zbutjen e papunësisë duke promovuar bujqësinë;
- Ndërtimin e një dige e cila do të mundësojë sigurimin e ujit të pijshëm dhe ujitjen e 5,000 ha tokë;
- Furnizimin e Komunës me rrymë elektrike, projekt veçse i nisur nga Qeveria Zvicerane që do të përfundoj brenda 2 viteve;
- Ndërrimin e gypave të ujit në gjatësi 4 km në vlerë prej 1 milion euro, projekt i cili do të realizohet në këtë mandat;
- Evitimin e problemit të kanalizimit;
- Përfundimin e trotuari në fshatin Pozhoran dhe në fshatrat tjera;
- Përfundimin e palestrës sportive deri në mbarim të vitit 2010;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN)